



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 4.12.2024

Nr: 202

Ora: 13:00

VENDIM

PËR

**PËRZGJEDHJEN E EKSPERTËVE KONTABËL TË LICENSUAR (AUDITUES  
LIGJOR) PËR AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA  
NGA SUBJEKTET ZGJEDHORE PËR FUSHATËN ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET  
PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË, TË DATËS 4 GUSHT 2024**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “ë” e 2, 92/6 dhe 92/7, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 15, datë 26.1.2022, “Për disa shtesa në udhëzimin nr. 14, datë 9.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

VENDOS:

1. Përzgjedhjen e ekspertëve kontabël të licensuar (auditues ligjor), të cilët do të auditojnë subjektet zgjedhore për fondet e përfituara dhe shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore, për zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024, si më poshtë vijon:

**1) Silvana Gjikhima:**

1. Partia Socialiste e Shqipërisë;
2. Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut.

**2) Eneida Rahmani:**

1. Partia Republikane Shqiptare;
2. Partia Fryma e Re Demokratike.

**3) Alda Preçe:**

1. Partia Demokristiane e Shqipërisë;

Data: 4.12.2024

Nr: 202  
Ora: 13:00



Për përzgjedhjen e ekspertëve kontabël të licensuar (auditues ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore për zgjedhjet për kryetar të bashkisë himarë, të datës 4 gusht 2024

2. Partia Balli Kombëtar Demokrat.

**4) Fatmira Kastrati:**

1. Partia e Lirisë;
2. Partia Demokratike.

**5) Meri Lika:**

1. Partia Balli Kombëtar;
2. Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë.

**6) Iris Qirjaqi:**

1. Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar.

2. Ekspertët kontabël të licensuar (audituesit ligjorë) do të paraqesin pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve raportet e auditimit për fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e lidhjes së kontratës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**